



**VENDIM**

*Nr. 57 Date 03.08.2009*

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË  
TEC – VLORA SH.A PËR TARIFËN E SHITJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE TEK FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICE (FPSH)**

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika “3” dhe 20 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin Nr.21, dt.18.03.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Vendimit nr.77, datë 26.06.2008 të Bordit të Komisionerëve “Për Miratimin e Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifës për Kompaninë Publike të Gjenerimit të Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.08.2009, mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të TEC – Vlora sh.a për tarifën e shitjes së energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH),

**Vendosi:**

1. Të filloj proçedurat për shqyrtimin e aplikimit të TEC – Vlora sh.a për tarifën e shitjes së energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH),
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



---

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

***VENDIMIN***

***Nr. 50 Date 03.08.2009***

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE PER SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË**  
**TEC – VLORA SH.A PËR TARIFËN E SHITJES SË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE TEK FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICE (FPSH)**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkëlqim Bozgo</b>	_____	_____